



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:154475

Datë: 06.08.2024

Numri i dokumentit: 06021663

2023:154476

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit A.H nga Ferizaj, i akuzuar për veprën penale, Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par. 2 të KPRK- së, Nr. 06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.1937/22 të dt.14 Korrik 2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 01 Gusht 2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylja-Hyseni dhe të pandehurit, në mungesë të përfaqësuesit të të dëmtuarës, me dt.05 Gusht 2024 mori, shpalli, ndërsa me dt.06.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri, A.H nga Ferizaj, me adresë banimi në rrugën “...” kompleksi banesor “...” kati .. nr. ..., i lindur më dt..., nga i ati I... dhe e ëma F..., e gjinisë V..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe të Mbreterisë së Suedisë , i shkurorëzuar, prind i 3 femijeve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së mesme, ekonomike, me nr.personal:...

ËSHTË FAJTOR

Sepse gjatë vitit 2021 dhe 2022, i pandehuri me qëllim të pengimit të realizimit të së drejtës pronësore ka tjetërsuar veturën e markës "...", ngjyrë e ..., viti i prodhimit ..., me numër të shasisë: ..., veturën e markës "... ngjyrë e ..., viti i prodhimit ... me nr. të shasisë: ..., si dhe veturën e markës ".." ... ngjyrë e ...me numër të shasisë: .., të njëjtat vetura ishin në kërkim nga autoritetet policore Suedeze - Interpol, e të cilat vetura ishin marrë me kredi në shtetin Suedez nga i pandehuri, në atë mënyrë që veturën e markës "...", e kishte regjistruar në RKS emër të personit A. H., e njëjta veturë është sekuestruar dhe kthyer pronarit - kompanisë "... AB -Suedi, vetura e markës "... gjithashtu është sekuestruar dhe pritet ti kthehet pronarit legjitim, ndërsa veturën e markës "... i pandehuri e kishte regjistruar në RKS në emër të I.H., e më pas e kishte dërguar në destinacion të panjohur me qëllim për ta fshehur, ashtu që edhe pse kishte qenë i njoftuar sipas kontratave që të njëjtat ti ruan dhe të mos i tjetërsojë, apo ti largojë nga shteti i Suedisë, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vlerë të pa përcaktuar.

Me këto veprime, i pandehuri ka kryer veprën penale, Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par. 2 të KPRK- së, Nr. 06/L-074.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 3000.00 € (tremijë euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë brenda afatit prej 30 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në tri këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t'a zevendesojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 30.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave te Krimin shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuara, Kompania “....” në, Mbretëria e Suedisë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri, që automjetin e markës “...”... ngjyrë e zezë, me nr. të shasisë: ..., t’i dorëzojë të dëmtuarit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzen PP.II.nr.1937/22 të dt.14 korrik 2023, të pandehurin A.H nga Ferizaj, e ka akuzuar për veprën penale, Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par. 2 të KPRK- së, Nr. 06/L-074.

Në bazë të kesaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 01 Gusht 2024.

Prokurori I shtetit Mimoza Sylja-Hyseni në fjalën e tij, me rastin e prezentimit te aktakuës , deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës se parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës, nuk ka qenë prezent në shqyrtimin fillestar.

I pandehuri ne fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se, siq e ka thënë edhe ne Stacionin Policor nuk e kishte lexuar mjaftueshëm marrëveshjen me kompaninë, gjegjësisht nuk e kishte vërejtur detyrimin e tij, qe automjetet në fjalë që mos i largojë nga shteti i Suedisë, me gjithate i njëjti thekson se normalisht se e ndien veten të penduar për veprimet e tij dhe i premtion gjykatës edhe njëherë se këso veprime apo te tjera të ngjajshme nuk do të përsërisë në të ardhmen, prandaj edhe ne këtë rast i kërkon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit t’i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur.

Prokurorja e shtetit, në fjalën e saj, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i akuzuar për veprën penale, Dëmtimi I të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par.2 të KPRK-së, Nr.06/L-074, pasi që një pranim i tillë, u bë vullnetarisht nga ana e te pandehurit,

si dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 242 të KPPK-së. Andaj I propozon gjykatës, që të bëjë pranimin e fajësisë për të pandehurin dhe t'i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në senacën e shqyrtimit fillestar, ndërsa rrethanë rënduese, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këtë gjykata vertetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par. 2 të KPRK-së, Nr. 06/L-074.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethane lehtësuese gjykata pati parasysh faktin se, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, në tërësi në shqyrtimin fillestar, duke shprehur keqardhje dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti shkallën e konsiderueshme të dëmit të shkaktuar ndaj të dëmtuarës, duke patur parasysh vlerën e këtyre automjeteve.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin A.H, i akuzuar për veprën penale, Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par. 2 të KPRK-së, Nr. 06/L-074, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së, ndërsa vendimi për kthimin e automjetit të markës “...”166, ngjyrë e zezë, me nr. të shasisë: ...është marrë konform nenit 463 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2023:154476 datë 06.08.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.